



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 maj 2012

Nr.Ref.:RK233/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 129/10

Parashtruesi

Agron Xhaferi

**Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës A. nr. 15/2003 të 30 qershorit 2004**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Z. Agron Xhaferi, me banim në Prishtinë, të cilin e përfaqëson z. Ferki Xhaferi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutë është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr 15/2003 i 30 qershorit 2004, i cili i është dorëzuar parashtruesit të Kërkesës më 5 korrik 2004.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr 15/2003 të 30 qershorit 2004, ku parashtruesi i Kërkesës pretendon që me këtë aktgjykim i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, për shkak të refuzimit të ankesës se tij, si e të pabazuar, lidhur me kundërshtimin e vendimeve e të Shërbimit Doganor të Kosovës, përkatësisht, me procedurat e vlerësimit të mallit ne pikën doganore të Pejës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe Rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtuese

5. Më 22 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 14 shkurt 2011 Kryetari me vendimin GJR KI 129/10 caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtaren Iliriana Islami. Të njëjtën ditë, Kryetrari, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Enver Hasani (anëtar).
7. Më 27 janar 2011, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës.
8. Më 4 maj 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 18 qershor 2002, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur Kontratë me ndërmarrjen “Fabrika Duhana Sarajeva” me qëllim të blerjes së duhan cigareve të llojit “ Aura”, për import dhe shitje me pakicë në tregun e Kosovës.
10. Më 27 shtator 2002, në Degën Doganore në Pejë kishte arritur një sasi e duhanit në bazë të faturës nr. 22 të 23 shtatorit 2002, me ç’rast parashtruesi pretendon se malli i tije është mbivlerësuar në dëm të tij dhe në bazë të vlerësimit të mallit, i është caktuar edhe lartësia e pagesës doganore me të cilën parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë dakord.
11. Parashtruesi i kërkesës, pohon se, më 11 nëntor 2002 në baze të prezantimit të Dokumentit Unik Doganor nr.17419 nga i cili rezulton se në të njëjtën pikë doganore, me të njëjtin lloj të mallit, ka kaluar procedurat doganore ndërmarrja “ Gradina” nga Zveqani malli i së cilës është vlerësuar shumë më ulët krahasuar me vlerësimin që i është bërë parashtruesit të kërkesës.

12. Më 15 nëntor 2002, Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, pas paraqitjes së Kërkesës për përsëritje të procedurës nga ana e parashtruesit të kërkesës, nxori vendimin 07/Nr.2391, me ç'rast e refuzoi kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës lidhur me vlerësimin e vlerës doganore të mallit (duhanit), pasi që në Nenin 129 paragrafi 2 të Ligjit të Aplikueshëm Doganor thuhet se, kundërshtimi nuk mund të ushtrohet pasi që malli lëndor të dalë nga mbikëqyrja Doganore, si dhe nga shkresat e lëndës shihet se, vlera doganore e caktuar, është caktuar drejtë dhe në përputhje me nenin 35 të Ligjit Doganor.
13. Më 26 nëntor 2002, Drejtori i Shërbimi Doganor i emëruar nga Administrata e UNMIK-ut, duke vendosur në shkallë të dytë në bazë të ankesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimit 07/Nr.2391, nxori vendimin nr. 2391, me ç'rast e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pa bazë. Më tutje në arsyetim thuhet se, organi i shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe konform metodës së përcaktuar me nenin 35 të Ligjit të aplikueshëm Doganor.
14. Më 30 qershor 2004, Gjykata Supreme, pas ushtrimit të padisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, nxori aktgjykimin A.nr.15/2003 dhe e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës kishte kërkuar që të priset vendimi i shërbimit doganor 07 nr. 2392 i 16 dhjetorit 2002. Në arsyetimin e kësaj gjykate thuhet se, parashtruesi i kërkesës (paditësi) nuk ka paraqitur prapësim në afatin e paraparë, siç është përcaktuar me nenin 129 të Ligjit të aplikueshëm Doganor të Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr 15/2003 të 30 qershorit 2004, i janë shkëlur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si në vijim:
 - Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës;
 - Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës;
 - Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës;
 - Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe
 - Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.
17. Në lidhje me këtë kërkesës, Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesi i kërkesës konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr 15/2003 të 30 qershorit 2004. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, respektivisht para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, në bazë të kësaj, kërkesa është dorëzuar pas afatit kohor të parapare dhe kësaj nuk është në përputhje "*ratione temporis*" me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit (shih *mutatis mutandis* Jasiūnienė kundër Lituanisë, Kërkesa nr. 41510/98, aktgjykimi i GJEDNJ-së të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003).

18. Rrjedhimisht kërkesa është e papranueshme në pajtim me rregullin 36.3 (h) të Rregullores së Punës që parasheh:
Rregulli 36.3(h) „një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.“

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim Rregullin 36.3 (h), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 maj 2012, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues

Dr. Iliriana Islami

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani